

VENDIM
Nr. 399, datë 9.6.2022

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË
ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE “ERSEKA SOLAR PARK 2” DHE VEPRAVE
NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN E ERSEKËS,
BASHKIA KOLONJË, QARKU I KORÇËS, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I
SHOQËRIVE “FAVINA” SHPK, “FAVINA 1” SHPK DHE “M&K ENERGY TRADING
CO” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike “Erseka Solar Park 2” dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading CO” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emrin e aplikuesit: Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading CO” sh.p.k.;

b) Numrin e identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS:

“Favina” sh.p.k.: J64104078V;

“Favina 1” sh.p.k.: K54624001I;

“M&K Energy Trading CO” sh.p.k.: M04516001I;

c) Tipin e centralit: fotovoltaike;

ç) Kapacitetin e instaluar: 20 mw;

d) Afatin e pritshëm të vënies në punë: koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut fotovoltaike do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

dh) Vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë: në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës;

e) Afatin e operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ose institucione të tjera të autorizuar kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading CO” sh.p.k., i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaike. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading CO” sh.p.k., dhe shoqëria për qëllime të veçanta do të jenë bashkërisht përgjegjëse për detyrimet sipas këtij miratimi dhe kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike “Erseka Solar Park 2” dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 20 mw, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë për qëllime të veçanta mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

h) Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading CO” sh.p.k., ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ose institucioneve të tjera të autorizuar informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaike;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading CO” sh.p.k., ose shoqërisë për qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Favina” sh.p.k., “Favina 1” sh.p.k. dhe “M&K Energy Trading CO” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

Sistemi koordinativ KRRGJSH, SIP.=32.16 Ha

Nr.	Veri	Lindje
1	4470415.52	559651.38
2	4470419.85	559704.17
3	4470456.22	559695.22
4	4470468.29	559732.13
5	4470495.14	559736.07
6	4470500.52	559727.29
7	4470500.36	560167.50
8	4470477.09	560177.14
9	4470466.88	560186.09
10	4469967.84	560186.09
11	4469970.28	560153.08
12	4469960.29	560132.46
13	4469952.90	560106.78
14	4469928.33	560078.94
15	4469896.11	560005.78
16	4469867.91	559973.86
17	4469883.49	559967.37
18	4469899.96	559967.26
19	4469931.68	559940.09
20	4469893.64	559853.17
21	4469868.15	559836.57
22	4469849.97	559774.64
23	4469814.11	559747.30
24	4469804.58	559703.38
25	4469779.03	559651.38